




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM  
KORÇË



Korçë, më 22.01.2024

**SHPLLJE VENDIMI**

**Drejtuar :** **Njësia Administrative Pojan.**

Për shtetasin/en: Miranda Shpata (Dede)  
Me adresë: Fshati Plasë, Njësia Administrative Pojan,  
Bashkia Maliq.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë shpalljen për vendimin civil nr. 940 dt. 07.12.2023 për t'u afishuar nga ana juaj njoftimi me shpallje me afat *20 ditor*, pasi dëftesa e komunikimit është kthyer me shënimin : " larguar " dhe pas afishimit kjo shpallje të na kthehet e konfirmuar me vulë e firmë, në gjykatë.

**KANCELARE**  
**Geralda Kasuli**



U afishua sot në datë -----  
Për Bashkinë

\_\_\_\_\_  
(emër, mbiemër, firmë)

Mr. 18 Prost  
Dt. 26.01.2024

- Xj. A. Pojan  
- ST 18 P ✓  
dt 25.01.2024



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË**  
**E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM**  
**KORÇË**

Nr.regj.them.21233-00306-41-2019 (62/67/77/103/655)  
Date regjistrimi 21.02.2019

Nr.vendimi 41-2023-3716 (940)  
Datë vendimi 01.12.2023

**VENDIM**  
**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me trup gjykues të përbërë prej:

Gjyqtarit të vetëm **Seladin PYSQYLI**, asistuar nga sekretare gjyqesore Eriselda Elmazaj, sot më datë 01.12.2023, përfundoi gjykimin e çështjes civile me palë dhe objekt:

**PADITËS:** Zyra Përmbartimore Korçë, përfaqshuar nga përmbartuesja Enkeleida Kota.

**TË PADITUR:** 1-**Ermir Dede**, i biri i Istref dhe Xhenete, i datëlindjes 21.11.1971, lindur e banues në fshatin Progër, Njësia Administrative Progër, Bashkia Devoll, përfaqshuar nga avokat Nevzat Tarelli antar i Dhomës Vendore të Avokatëve Korçë.

2-**Miranda Shpata (Dede)**, e bija e Istref dhe Xhenete, e datëlindjes 22.11.1965, lindur në fshatin Progër, Njësia Administrative Progër, Bashkia Devoll dhe banuese në fshatin Plasë, Njësia Administrative Pojan, Bashkia Maliq.

3-**Fabiola Demiraj (Dede)**, e bija e Istref dhe Xhenete, e datëlindjes 30.07.1980, lindur në fshatin Progër, Njësia Administrative Progër, Bashkia Devoll dhe banuese në fshatin Eçmenik, Njësia Administrative Hoçisht, Bashkia Devoll, përfaqshuar nga e paditura Miranda Shpata e zgjedhur me prokurë të posaçme nr.525 rep e 261 kol datë 25.03.2023, hartuar para noteres Alketa Mulla në qytetin e Bilishtit.

4-**Hasan Sulejmani**, i biri i Fatmir dhe Zarife, i datëlindjes 23.03.1964, lindur e banues në fshatin Mollaj (Dvoran), Njësia Administrative Mollaj, Bashkia Korçë, përfaqshuar nga i padituri Florian Sulejmani i zgjedhur me prokurë të posaçme nr.3412 rep e 1640 kol datë 25.05.2023, hartuar para noteres Denada Kodra në qytetin e Korçës.

5-**Florian Sulejmani**, i biri Hasan dhe Desdemona, i datëlindjes 20.06.1999, lindur e banues në fshatin Mollaj (Dvoran), Njësia Administrative Mollaj, Bashkia Korçë.

6-**Sonila Sulejmani**, e bija e Hasan dhe Desdemona, e datëlindjes 04.07.1996, lindur e banues në fshatin Mollaj (Dvoran), Njësia Administrative Mollaj, Bashkia Korçë, përfaqshuar nga i padituri Florian Sulejmani.

**Istref Dede**, i biri Isa dhe Fatime, i datëlindjes 17.04.1935, banues në fshatin Progër, Njësia Administrative Progër, Bashkia Devoll. Ky i paditur ka ndruar jetë më datë 12.05.2021, dhe në bazë paragrafit të parë të nenit 199 të K.Pr.Civile, u bë kalimi procedural duke thirrur trashëgimtarët e tij, që janë të paditurit: 1-Ermir Dede, 2-Miranda Shpata (Dede), 3-Fabiola Demiraj (Dede), 4-Sonila Sulejmani, dhe 5-Florian Sulejmani.

**OBJEKTI:** Veçimin e pjesës së debitorit Ermir Dede, nga pasuria e paluajtshme që ai ka në bashkëpronësi me të paditurit e tjerë, për pasuritë:



Përmbaremore Korçë dhe ka kërkuar ekzekutimin e detyrimit për shumën si më sipër. Pasi ka regjistruar kërkesën, Zyra Përmbaremore Korçë ka filluar procedurat për ekzekutimin vullnetar dhe m.q.s. ekzekutimi nuk është bërë në mënyrë vullnetare, ka filluar ekzekutimin e detyrueshëm. Nga verifikimet e bëra në lidhje me pasuritë e debitorit Ermir Dede, ka rezultuar se ai kishte përfituar tokë arë në bazë të ligjit 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën". Toka ndodhet në fshatin Progër, Njësia Administrative Progër, Bashkia Devoll dhe është fituar sipas normës për frymë. Ky fakt është dokumentuar me aktin e marrjes së tokës në pronësi në emrin e k/familjarit Istref Dede (babai i debitorit Ermir Dede). Toka dhe shtëpia janë regjistruar si pasuri e familjes bujqësore në ish ZVRPP Devoll sot ASHK dhe përbëhet nga tetë pasuri tokë arë dhe një pasuri shtëpi banimi dhe truall 300 m<sup>2</sup>.

-Nisur nga fakti që debitorit Ermir Dede nuk i është gjetur pasuri vetjake, Zyra Përmbaremore Korçë i është drejtuar gjykatës me këtë padi dhe ka kërkuar veçimin e pjesës takuese të debitorit nga sendet në bashkëpronësi me të paditurit e tjerë. Duke qënë një padi e ngritur në fazën e ekzekutimit, Zyra Përmbaremore Korçë legjitimohet në ngritjen e saj, pasi neni 578 i K.Pr.Civile parashikon: *"Kur ekzekutimi bëhet mbi një send të paluajtshëm që është në bashkëpronësi, për detyrimin që ka ndonjë nga bashkëpronarët bëhet sekuestrimi i sendit. Përmbareuesi gjyqësor i bën kërkesë gjykatës për veçimin e pjesës takuese të debitorit bashkëpronar dhe mbi këtë pjesë bëhet ekzekutimi. Sendi mund të shitet në tërësi, kur për këtë kanë dhënë pëlqimin të gjithë bashkëpronarët e tjerë. Pëlqimi duhet të jepet me akt noterial."* Po kështu, edhe të paditurit kanë legjitimitimin pasiv, pasi janë bashkëpronarë të pasurive të paluajtshme nga të cilat kërkohet të veçohet pjesa e debitorit Ermir Dede.

-Në fazën e parë, gjykata, pasi ka dëgjuar pretendimet e palëve, ka analizuar provat dhe ka marrë mendimin e ekspertit, me vendim datë 09.10.2020 ka vendosur: Lejimin e pjestimit të pasurive: 1-Pasuria me nr.97/25, toke arë me sipërfaqe 1339 m<sup>2</sup>, e ndodhur në fshatin Progër Njësia Administrative Progër, Bashkia Devoll, Zona Kadastrale 3056, regjistruar në volumnin 2, faqe 61, me kufij: V-Pasuria 97/26; L-pasuria 97/59; J-pasuria 97/24; dhe P-pasuria 267; 2-Pasuria me nr.102/25, tokë arë me sipërfaqe 4637 m<sup>2</sup>, e ndodhur në fshatin Progër Njësia Administrative Progër, Bashkia Devoll, Zona Kadastrale 3056, regjistruar në volumnin 2, faqe 62, me kufij: V-Pasuria 102/24; L-pasuria 271; J-pasuria 271; dhe P-pasuria 270/1; 3-Pasuria me nr.199/18, tokë arë me sipërfaqe 1160 m<sup>2</sup>, e ndodhur në fshatin Progër Njësia Administrative Progër, Bashkia Devoll, Zona Kadastrale 3056, regjistruar në volumnin 2, faqe 63, me kufij: V-Pasuria 199/19; L-pasuria 199/77; J-pasuria 199/17; dhe P-pasuria 493; 4-Pasuria me nr.105/3, tokë arë me sipërfaqe 530 m<sup>2</sup>, e ndodhur në fshatin Progër Njësia Administrative Progër, Bashkia Devoll, Zona Kadastrale 3056, regjistruar në volumnin 2, faqe 84, me kufij: V-Pasuria 284; L-pasuria 105/2; J-pasuria 255; dhe P-pasuria 105/4; 5-Pasuria me nr.112/69, truall dhe ndërtesë me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup> nga e cila 107 m<sup>2</sup> ndërtesë, e ndodhur në fshatin Progër Njësia Administrative Progër, Bashkia Devoll, Zona Kadastrale 3056, regjistruar në volumnin 6, faqe 108, me kufij: V-Pasuria 112/55; L-pasuria 112/73; J-pasuria 112/70; dhe P-pasuria 111. Po kështu, **gjykata ka përcaktuar pjesët takuese për të pesë pasuritë si vijon: 1-Ermir Dede 6/25 pjesë; 2-Istref Dede 6/25 pjesë; 3-Miranda Shpata (Dede) 1/25 pjesë; 4-Hasan Sulejmani 2/25 pjesë; 5-Sonila Sulejmani 2/25 pjesë; 6-Florian Sulejmani 2/25 pjesë; dhe 7-Fabiola Demiraj 6/25 pjesë.**

-Vendimi i fazës së parë ka marrë formë të prerë më datë 05.05.2021 dhe gjykata ka thirrur palët në seancë gjyqësore më datë 08.07.2021, për vijimin e gjykimit në fazën e dytë të pjestimit, me qëllim veçimin e pjesës së debitorit Ermir Dede. Në këtë seancë, gjykata është vënë në dijeni të faktit që i padituri Istref Dede kishte vdekur më datë 12.05.2021 dhe nisur



tokë arë me sipërfaqe 4637 m<sup>2</sup> është 1,854,800 lekë (4637m<sup>2</sup> x 400 lek/m<sup>2</sup>). 3-Vlera e pasurisë 199/18, tokë arë me sipërfaqe 1160 m<sup>2</sup> është 348,000 lekë (1160 m<sup>2</sup> x 300 lek/m<sup>2</sup>). 4-Vlera e pasurisë 105/3, tokë arë me sipërfaqe 530 m<sup>2</sup> është 106,000 lekë (530 m<sup>2</sup> x 200 lek/m<sup>2</sup>). 5-Vlera e pasurisë 112/69, shtëpi banimi është 1,200,000 lekë. Vlera totale e të pesë pasurive është 3,910,500 (tremilione nëntëqind e dhjetë mijë e pesëqind) lekë.

3-Vlera në lekë sipas pjesëve takuese për secilin të paditur është: 1-Ermir Dede 30/100 pjesë të shumës 3,910,500 lekë, ose 1,173,150 lekë. 2-Miranda Shpata (Dede) 10/100 pjesë të shumës 3,910,500 lekë, ose 391,050 lekë. 3-Hasan Sulejmani 8/100 pjesë të shumës 3,910,500 lekë, ose 312,840 lekë. 4-Sonila Sulejmani 11/100 pjesë të shumës 3,910,500 lekë, ose 430,155 lekë. 5-Florian Sulejmani 11/100 pjesë të shumës 3,910,500 lekë, ose 430,155 lekë. 6-Fabiola Demiraj (Dede) 30/100 pjesë të shumës 3,910,500 lekë, ose 1,173,150 lekë.

Përveç sa më sipër, eksperti vlerësues bëri llogaritjet në lidhje me kompensimin në lekë të pabarazisë së pjesëve n.q.s. një pjesë nga të paditurit i lihen sendet në pronësi.

Pas diskutimit të aktit të ekspertimit, të paditurit Miranda Shpata (Dede), Hasan Sulejmani, Sonila Sulejmani, Florian Sulejmani dhe Fabiola Demiraj (Dede) bashkuan pjesët e tyre dhe dhanë pëlqimin që të vecohet pjesa e debitorit Ermi Dede. Pas bashkimit të pjesëve, raporti shkoi në 30/100 pjesë për debitorin Ermir Dede dhe 70/100 pjesë 5 të paditurit e tjerë. Po kështu, pesë të paditurit propozuan që i padituri Ermir Dede të marrë pjesën e tij në natyrë në pasuritë tokë arë, për sipërfaqe me vlerë të barabartë sa pjesa takuese. Në lidhje me këtë pretendim ishte dakort përfaqësuesi i debitorit Ermir Dede dhe përfaqësuesja e Zyrës Përmbartimore Korçë.

Nisur nga marrëveshja e palëve, gjykata i la detyrë ekspertit të japë mendimin në lidhje me mundësinë e ndarjes në natyrë në raportin e pjesëve 30/100 pjesë për Ermir Dede dhe 70/100 pjesë për pesë të paditurit. Ekspertët bënë llogaritjen në vlerë sipas raporteve më sipër, si dhe mundësinë e ndarjes në natyrë. Vlera në lekë për 30/100 pjesë është 1,173,000 lekë kurse për 70/100 pjesë është 2,737,350 lekë. Në lidhje me ndarjen në natyrë, ekspertët dha mendimin se duke marrë parasysh mundësinë për shfrytëzimin e pasurisë, rrejtin kullues e vaditës dhe rrjetin rrugor, në natyrë mund të ndahet vetëm pasuria me nr.102/25, e cila ndahet në dy parcela, parcela "A" me sipërfaqe 3817 m<sup>2</sup> dhe parcela "B" me sipërfaqe 820 m<sup>2</sup>, duke paraqitur planvendosjen përkatëse në lidhje me mënyrën e ndarjes. Sipas këtij varianti, ekspertët dhanë mendimin se: Të paditurit Ermir Dede mundet ti lihen në pronësi pasuritë me nr.97/25, 199/18, 105/3, 112/69 dhe pjesa "B" nga pasuria 102/25, dhe vlera e tyre është 1,183,700 lekë. Pesë të paditurve të tjerë ti lihet pasuria 112/69 dhe pjesa "A" e pasurisë 102/25 me vlerë 2,726,800 lekë. Sipas kësaj mënyre, Ermir Dede duhet të kompensojë pesë të paditurit e tjerë në vlerën 10,550 lekë. Varianti i dytë ishte që Ermir Dede ti lihet veëm pasuria 112/69 kurse të paditurve të tjerë 4 pasuritë e tjera dhe Ermir Dede ti kompensojë për diferencën e vlerës prej 26,850 lekë.

Pasi u njohën me mendimin e ekspertëve, të paditurit ranë dakort që vecimi i pjesës së debitorit Ermir Dede të bëhet duke i lënë atij pasuritë me nr.97/25, 199/18, 105/3, 112/69 dhe pjesën "B" nga pasuria 102/25. Në lidhje me variantin e dytë, që pasuria 112/69 ti lihet debitorit Ermir Dede, të pesë të paditurit dhe përfaqësuesi i debitorit nuk ishin dakort dhe nuk pranuan të japin pëlqimin për vecimin e pjesës sipas këtij varianti.

Gjykata, pasi dëgjoi palët, analizoi provat e marra në gjykim dhe morri mendimin e ekspertëve, vlerëson se padia duhet të pranohet, duke u bërë vecimi i pjesë së debitorit (të paditurit) Ermir Dede në pasuritë nr.97/25, 102/25, 199/18, 105/3 dhe 112/69. Përsa i takon pasurive që duhet ti lihen atij në natyrë, gjykata cmon se duhet ti lihen pasuritë me nr.97/25,



d-Pasuria me nr.105/3, tokë arë me sipërfaqe 530 m2, e ndodhur në fshatin Progër, Njësia Administrative Progër, Bashkia Devoll, Zona Kadastrale 3056, regjistruar në volumn 2, faqe 84, me kufij: V-Pasuria 284; L-pasuria 105/2; J-pasuria 255; dhe P-pasuria 105/4.

3-Të paditurve Miranda Shpata (Dede), Hasan Sulejmani, Sonila Sulejmani, Florian Sulejmani dhe Fabiola Demiraj (Dede) për 70/100 pjesë takuese së bashku i lihen pasuritë:

a)-Pjesa "A" e pasurisë me nr.102/25, e pasqyruar me ngjyrë të kuqe në planvendosje, tokë arë me sipërfaqe 3817 m2, e ndodhur në fshatin Progër, Njësia Administrative Progër, Bashkia Devoll, Zona Kadastrale 3056, regjistruar në volumn 2, faqe 62, me kufij: V-Pasuria 102/24; L-pasuria 271; J-pasuria 102/25 (pjesa "B"); dhe P-pasuria 270/1.

b)-Pasuria me nr.112/69, truall dhe ndërtesë me sipërfaqe 300 m2 nga e cila 107 m2 ndërtesë, e ndodhur në fshatin Progër Njësia Administrative Progër, Bashkia Devoll, Zona Kadastrale 3056, regjistruar në volumn 6, faqe 108, me kufij: V-Pasuria 112/55; L-pasuria 112/73; J-pasuria 112/70; dhe P-pasuria 111.

4-Pas ekzekutimit të pjesës së debitorit Ermir Dede, Zyra Përmbartimore Korçë, duhet të kompensojë bashkërisht të paditurit Miranda Shpata (Dede), Hasan Sulejmani, Sonila Sulejmani, Florian Sulejmani dhe Fabiola Demiraj (Dede) me vlerën 10,550 (dhjetëmijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë.

5-Skica e planvendosjes e hartuar nga eksperti Robert Papi për pasurinë nr.102/25, planvendosja 2/1 e aktit të ekspertimit shtesë, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

6-Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe në rast se nuk ekzekutohet vullnetarisht, ekzekutimi i tij bëhet nga shërbimi përmbartimor gjyqësor privat ose shtetëror, sipas kërkesës së palës kreditore.

7-I padituri Ermir Dede (debitori në fazën e ekzekutimit) detyrohet të paguajë në favor të Zyrës Përmbartimore Korçë shumën prej 63,000 (gjashtëdhjetë e tre mijë) lekë, e cila përfaqson shpenzimet gjyqësore të kryera dhe të parapaguara nga paditësi.


8-Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.


9-U shpall në Korçë, sot më datë 01.12.2023

**SEKRETARE**  
**Eriselda ELMAZAJ**



**GJYQTAR**  
**Seladin PYSQYLI**





RR 561 574 443 AA



199/18, 105/3, 112/69 dhe pjesa "B" nga pasuria 102/25, me vlerë 1,183,700 lekë, kurse të padituve Miranda Shpata (Dede), Hasan Sulejmani, Sonila Sulejmani, Florian Sulejmani dhe Fabiola Demiraj (Dede) ti lihet pasuria 112/69 dhe pjesa "A" e pasurisë 102/25 me vlerë 2,726,800 lekë. Sipas kësaj mënyre pesë të paditurit duhet të kompensohen me vlerën 10,500 lekë nga pjesa takuese e debitorit Ermir Dede.

Gjykata nuk mund të marrë parasysh vecimin e pjesës sipas variantit të dytë, duke i lënë atij pasurinë 112/69, pasi për këtë pasuri nuk dhanë pëlqimin të gjithë bashkëpronarët e tjerë konform nenit 578 të K.Pr.Civile. Duke disponuar si më sipër i jepet fund bashkëpronësisë midis debitorit Ermir Dede dhe bashkëpronarëve të tjerë dhe Zyra Përmbartimore Korçë nuk ka pengesë të vijojë procedurat e ekzekutimit të detyrueshem mbi pasuritë që i lihen debitorit. Po kështu, pas ekzekutimit, nga shuma e përfituar, Zyra Përmbartimore duhet të kompensojë të paditurit në vlerën 10,500 lekë gjithsej.

Në lidhje me shpenzimet gjyqësore, të cilat përbëhen nga tarifa mbi aktet 3,000 lekë dhe shpërblimi i ekspertëve në vlerën 60,000 lekë të parapaguara nga pala paditëse duhet ti ngarkohen të paditurit, debitorit Ermir Dede, i cili me sjelljen e tij i ka dhënë shkak ngritjes së kësaj padie. Të paditurit nuk paraqitën ndonjë dokument në lidhje me shpenzimet e kryera dhe as pretenduan për shpenzime të kryera.

Ky vendim përbën titull ekzekutiv, pasi neni 510 i K.Pr.Civile, përcakton: "*Janë tituj ekzekutivë: a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmbajnë një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm*". Vendimi përmban detyrim konkret për vlerën e kompensimit, për rrjedhim përbën titull ekzekutiv. Sipas shkronjës "a" të nenit 511 të K.Pr.Civile i ndryshuar me ligjin nr.35/2017, urdhëri i ekzekutimit nuk lëshohet me vendim më vete por ky fakt cilësohet në dispozitivin e tij, pasi kjo dispozitë përcakton: "*Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim nëpërmjet lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, i cili: a) për rastet e parashikuara nga shkronja "a" dhe "b", të nenit 510, të këtij Kodi, lëshohet nga gjykata që ka dhënë vendimin në dispozitivin e vendimit*".

### **PËR KËTO ARSYE:**

Gjykata, bazuar në nenet 369-370 e 578 të K.Pr.Civile,

### **VENDOSI:**

**1-**Pranimin e padisë duke veçuar pjesën e debitorit (të paditurit) Ermir Dede nga sendet në bashkëpronësi me të paditurit Miranda Shpata (Dede), Hasan Sulejmani, Sonila Sulejmani, Florian Sulejmani dhe Fabiola Demiraj (Dede), që janë pasuritë me nr.97/25, 102/25, 199/18, 105/3 dhe 112/69, duke vendosur si më poshtë:

**2-**Debitorit Ermir Dede, për 30/100 pjesë takuese, i lihen në pronësi të vetme pasuritë:

**a)-**Pasuria me nr.97/25, tokë arë me sipërfaqe 1339 m<sup>2</sup>, e ndodhur në fshatin Progër, Njësia Administrative Progër, Bashkia Devoll, Zona Kadastrale 3056, regjistruar në volumin 2, faqe 61, me kufij: V-Pasuria 97/26; L-pasuria 97/59; J-pasuria 97/24; dhe P-pasuria 267.

**b)-**Pjesa "B" e pasurisë me nr.102/25, e pasqyruar me ngjyrë blu në planvendosje, tokë arë me sipërfaqe 820 m<sup>2</sup>, e ndodhur në fshatin Progër, Njësia Administrative Progër, Bashkia Devoll, Zona Kadastrale 3056, regjistruar në volumin 2, faqe 62, me kufij: V-Pasuria 102/25 (pjesa "A"); L-pasuria 271; J-pasuria 271; dhe P-pasuria 270/1.

**c)-**Pasuria me nr.199/18, tokë arë me sipërfaqe 1160 m<sup>2</sup>, e ndodhur në fshatin Progër, Njësia Administrative Progër, Bashkia Devoll, Zona Kadastrale 3056, regjistruar në volumin 2, faqe 63, me kufij: V-Pasuria 199/19; L-pasuria 199/77; J-pasuria 199/17; dhe P-pasuria 493.



nga ky fakt, me vendim datë 08.07.2021, ka vendosur pezullimin e gjykimit me qëllim ndjekjen e procedurave për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore dhe më pas të bëhej kalimi procedural, duke thirrur si të paditur trashëgimtarët e tij.

-Në muajin Shtator 2021, gjyqtari Maksim Qiriazhi ka ndruar jetë dhe pasi çështja është rihedhur në short i është caktuar për gjykim këtij trupi gjykues. Pas marrjes së akteve, gjykata thirri palët në seancë gjyqësore më datë 14.04.2022, me qëllim verifikimin nëse kishte rënë shkaku i pezullimit dhe rezultoi që shkaku nuk kishte rënë. Me kërkesën datë 13.06.2022, pala paditëse njoftoi gjykatën se ishte lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore për të ndjerin Istref Dede, duke vënë në dispozicion vendimin për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë nr.862 rep e 452/1 kol datë 27.05.2022, të noteres Alketa Mulla, antare e Degës Vendore të Noterëve Korçë. Sipas këtij vendimi Istref Dede ka vdekur më datë 12.05.2021 dhe pas vdekjes ka lënë si të vetëm trashëgimtarë ligjorë të rradhës së parë tre fëmijët: Miranda Shpata (Dede), Ermir Dede dhe Fabiola Demiraj, të cilët trashëgojnë nga 1/4 ose 2/8 pjesë secili të pasurisë së tij trashëgimore, si dhe dy fëmijët e vajzës së paravdekur Desdemonë Sulejmani (Dede), Sonila Sulejmani e Florian Sulejmani që trashëgojnë të dy së bashku 1/4 pjesë ose nga 1/8 pjesë secili të pasurisë trashëgimore të trashëgimtarit Istref Dede.

-Bazuar në dëshminë e trashëgimisë ligjore, gjykata thirri palët në seancë gjyqësore më datë 22.09.2022 dhe bazuar në nenin 298/2 të K.Pr.Civile vendosi ngritjen e çështjes nga pezullimi. Po kështu, bazuar në nenin 199/1 të K.Pr.Civile, gjykata bëri kalimin procedural, duke thirrur si të paditur në vend të të ndjerit Istref Dede trashëgimtarët e tij, Miranda Shpata (Dede), Ermir Dede, Fabiola Demiraj, Sonila Sulejmani dhe Florian Sulejmani, të cilët ishin palë e paditur që në fillim të gjykimit.

-Referuar vendimit të fazës së parë dhe vendimit për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, raporti i pjesëve takuese midis të paditurve, ka ndryshuar si vijon. **1-Ermir Dede 30/100 pjesë** ose 3/10 pjesë (6/25 ose 24/100 pjesë që kishte plus 1/4 e 6/25 të fituar me trashëgimi, e barabartë me 6/100, gjithsej 30/100); **2-Miranda Shpata (Dede) 10/100 pjesë** ose 1/10 pjesë (1/25 ose 4/100 që kishte plus 1/4 e 6/25 të fituar me trashëgimi e barabartë me 6/100, gjithsej 10/100); **3-Hasan Sulejmani 8/100 pjesë** (2/25 e barabartë me 8/100); **4-Sonila Sulejmani 11/100 pjesë** (2/25 ose 8/100 që kishte plus 1/8 e 6/25 pjesë të fituar me trashëgimi e barabartë me 3/100, gjithsej 11/100 pjesë); **5-Florian Sulejmani 11/100 pjesë** (2/25 ose 8/100 që kishte plus 1/8 e 6/25 pjesë të fituar me trashëgimi e barabartë me 3/100, gjithsej 11/100 pjesë); dhe **6-Fabiola Demiraj 30/100 pjesë** ose 3/10 (6/25 ose 24/100 që kishte plus 1/4 e 6/25 të fituar me trashëgimi e barabartë me 6/100, gjithsej 30/100);

Nisur nga natyra e mosmarrëveshjes, në kushtet kur për zgjidhjen e çështjes ishte e domosdoshme marrja e mendimit të specializuar nga ekspertë të fushës, topograf e vlerësues, bazuar në nenin 224/a të K.Pr.Civile gjykata vendosi kryerjen e një ekspertimi topografik dhe vlerësues, duke caktuar ekspert vlerësues nga "Multi-Studio 21" dhe topografin Robert Papi. Pasi ekspertët bënë betimin, gjykata i caktoi detyrat në lidhje me vlerën e sendeve, mundësinë e ndarjes ose jo në natyrë, variantet e ndarjes në raportet që ka debitori Ermir Dede dhe të paditurit e tjerë ose në raporte të tjera. Ekspertët hartuan skicat e planvendosjes për secilën pasuri dhe i paraqitën gjykatës aktin e ekspertimit me shkrim, duke dhënë mendimin si më poshtë:

1-Asnjëra nga 5 pasuritë nuk mund të ndahet në natyrë sipas raportit të pjesëve që ka secili bashkëpronar.

2-Vlera në këkë për secilën pasuri është si vijon: 1-Vlera e pasurisë 97/25, tokë arë me sipërfaqe 1339 m<sup>2</sup> është 401,700 lekë (1339 m<sup>2</sup> x 300 lek/m<sup>2</sup>). 2-Vlera e pasurisë 102/25,



1-Pasuria me nr.97/25, tokë arë me sipërfaqe 1339 m<sup>2</sup>, e ndodhur në fshatin Progër Njësia Administrative Progër, Bashkia Devoll, Zona Kadastrale 3056, regjistruar në volumnin 2, faqe 61, me kufij: V-Pasuria 97/26; L-pasuria 97/59; J-pasuria 97/24; dhe P-pasuria 267.

2-Pasuria me nr.102/25, tokë arë me sipërfaqe 4637 m<sup>2</sup>, e ndodhur në fshatin Progër Njësia Administrative Progër, Bashkia Devoll, Zona Kadastrale 3056, regjistruar në volumnin 2, faqe 62, me kufij: V-Pasuria 102/24; L-pasuria 271; J-pasuria 271; dhe P-pasuria 270/1.

3-Pasuria me nr.199/18, tokë arë me sipërfaqe 1160 m<sup>2</sup>, e ndodhur në fshatin Progër Njësia Administrative Progër, Bashkia Devoll, Zona Kadastrale 3056, regjistruar në volumnin 2, faqe 63, me kufij: V-Pasuria 199/19; L-pasuria 199/77; J-pasuria 199/17; dhe P-pasuria 493.

4-Pasuria me nr.105/3, tokë arë me sipërfaqe 530 m<sup>2</sup>, e ndodhur në fshatin Progër Njësia Administrative Progër, Bashkia Devoll, Zona Kadastrale 3056, regjistruar në volumnin 2, faqe 84, me kufij: V-Pasuria 284; L-pasuria 105/2; J-pasuria 255; dhe P-pasuria 105/4.

5-Pasuria me nr.112/69, truall dhe ndërtesë me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup> nga e cila 107 m<sup>2</sup> ndërtesë, e ndodhur në fshatin Progër Njësia Administrative Progër, Bashkia Devoll, Zona Kadastrale 3056, regjistruar në volumnin 6, faqe 108, me kufij: V-Pasuria 112/55; L-pasuria 112/73; J-pasuria 112/70; dhe P-pasuria 111.

*Pala paditëse ka kërkuar edhe cimin e pjesës së debitorit nga pasuritë: 1-Pasuria 97/25 tokë arë me sipërfaqe 1350 m<sup>2</sup> (1339 m<sup>2</sup>); 2-Pasuria 102/25 tokë arë me sipërfaqe 5453 m<sup>2</sup> (4637 m<sup>2</sup>); 3-Pasuria 199/18, tokë arë me sipërfaqe 1150 m<sup>2</sup> (1161 m<sup>2</sup>); Në lidhje me këto pasuri, paditësi ka paksuar objektin e padisë në fazën e parë të gjyqimit.*

**Baza Ligjore:** Nenet 369-374 e 578 të K.Pr.Civile.

Në përfundim të gjyqimit, përfaqësuesja e paditësit kërkoi pranimin e padisë duke u vendosur veçimi i pjesës së debitorit Ermir Dede nga bashkëpronarët e tjerë në 5 pasuritë objekt pjestimi.

Përfaqësuesi i të paditurit Ermir Dede kërkoi të vendoset vecimi i pjesës së debitorit Ermir Dede, duke i'u lënë atij pjesa takuese në pasuritë tokë arë.

Pesë të paditurit e tjerë bashkuan pjesët dhe kërkuan vecimin e pjesës takuese të debitorit Ermir Dede, duke i'u lënë atij pjesa takuese në pasuritë tokë arë.

Gjykata, pasi dëgjoi palët, analizoi provat e marra në gjykim dhe morri mendimin e ekspertit,

#### **VËREN SE:**

Me padinë drejtuar gjykates, paditësi ka kërkuar sipas objektit të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Padia i është nënshtruar shortit elektronik më datë 21.02.2019 dhe i është caktuar për gjykim, gjyqtarit Maksim Qiriazhi. Ky trup gjykues, pasi ka kryer veprimet paraprake konform neneve 158 e 158/a të K.Pr.Civile, ka vijuar fazën e parë të gjyqimit, duke përcaktuar raportin e pjesëve takuese të debitorit dhe bashkëpronarëve të tjerë.

Në përmbushje të detyrimeve që parashikon neni 370/1 i K.Pr.Civile, gjykata ka hetuar në lidhje me rrethin e bashkëpjesëtareve (bashkëpronarëve), sendet që do të pjestohen dhe pjesët takuese për secilin bashkëpronar, ku gjatë hetimit gjyqësor ka rezultuar se:

-Me vendim nr.508, datë 26.04.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është vendosur pjestimi i një shume prej 42,059 euro, midis Ermir Dede (i paditur në këtë gjykim) dhe shtetases Etleva Qose (Dede). Me këtë vendim, i padituri Ermir Dede është detyruar ti japë shtetases Etleva Qose (Dede) shumën prej 21,029 euro. M.q.s. detyrimi nuk është përmbushur vullnetarisht, shtetësja Etleva Qose, me cilësinë e kreditores, i është drejtuar me kërkesë Zyrës

